



MAR 2021



TITUJT

Editoriali i Koordinatorit të përherhshëm [faqja 1](#)

Përgjigja ndaj COVID-19 dhe aktivitetet tjera të OKB-së [faqja 2](#)

Programe dhe strategji individuale të agjencive të OKB-së [faqja 3](#)

Në fokus: Të dhënat [faqja 4](#)

NGJARJET MË TË RËNDËSISHME

SHKURT

18 - UNODC zhvilloi një takim me Drejtorinë e Doganave të Maqedonisë së Veriut për t'i diskutuar boshllëqet dhe nevojat e trajnimit, me qëllim që të rriten kapacitetet e Drejtorisë së Doganave të Maqedonisë së Veriut në lidhje me zbulimin e armëve, pjesëve të armëve dhe komponentëve tjerë, gjegjësisht municionit brenda dërgesave të postave të shpejta.

MARS

1-5 - e organizoi pjesën e parë të trajnimit themelor praktik për zyrtarët e Doganës dhe të Policisë Kufitare të Maqedonisë së Veriut, të cilët në të ardhmen do të angazhohen në grupet ndër-agjencish në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, si pjesë e aksionit të përbashkët mes UNODC-së dhe BE-së për kontroll të avancuar të kufirit, që financohet nga Bashkimi Evropian.

3-4 - Në bashkëpunim me Komisionin nacional për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm të Maqedonisë së Veriut, UNODC-ja organizoi një Takim rajonal të grupit të ekspertëve (TRGE) mbi "Qasjen në mjetet efektive juridike të viktimave të trafikimit të njerëzve në Evropën Juglindore".

8 - UN Women e zhvilloi një takim koordinues me Ministrinë e Mbrojtjes për ta diskutuar bashkëpunimin e ardhshëm në lidhje me zbatimin e planit të dytë nacional të veprimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe avancimin e barazisë gjinore në fushën e grave, paqes dhe sigurisë

16 - Fillimi i sezonit pranveror të Qendrës për edukim klinik, Program i ligjit për refugjatët i themeluar në shtator të vitit 2018 nga Fakulteti i Drejtësisë "Justinian Prima" në Shkup si një partneritet strategjik midis Fakultetit dhe Përfaqësuesisë së UNHCR-së në Maqedoninë e Veriut.

EDITORIAL Koordinator i përherhshëm i OKB-së

Ende mund t'i mbani mend ditët e para të krizës COVID-19, me imazhe të qiellit të pastër, të ambienteve të qytetit që rishfaqen pas smogut, si dhe imazhet e delfinëve pranë brigjeve për shkak të ndaljes së një morie të madhe të aktivitetëve njerëzore. Këto imazhe paraqesin kujtesë të gjallë të asaj që njerëzimi mund të bëjë për një herë, me qëllim që ta zvogëlojë gjurmën tonë ekologjike. Gjithashtu ato janë provë se nuk është vonë për ta rikthyer pasurinë natyrore të planetit tonë dhe për të krijuar ose mbajtur një mjedis të qëndrueshëm jetësor.

Gjatë ditëve të para të pandemisë ishim dëshmitarë të qyteteve që investuan në zgjidhje të favorshme dhe të qëndrueshme për mjedisin, siç janë zgjerimi i korsive të biçikletave ose zonave të këmbësorëve, të frymëzuar nga vizioni për t'i ndërtuar gjërat më mirë. Shumë zyrtarë qeveritarë dhe vendimmarrës e dëshmuar përkushtimin e tyre për të siguruar një rimëkëmbje të favorshme për mjedisin jetësor, në përputhje me thirrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Pas një viti disa nga këto premtime ende nuk janë mbështetur plotësisht. Një [studim i fundit](#) i OKB-së dhe Universitetit të Oksfordit zbulon se vetëm 18 për qind e pakove mbështetëse të qeverive në lidhje me COVID-19 nga 50 ekonomitë më të mëdha në vitin 2020 janë vlerësuar si "të gjelbërta", madje me disa pako rikuperimi që i mbështesin industritë me lëndë djegëse fosile. Në Maqedoninë e Veriut, pakot mbështetëse të qeverisë nuk janë vlerësuar për sa i përket përmbajtjes së gjurmëve të karbonit dhe mekanizmave të ndikimit në mjedisin jetësor, ndonëse duhet të merret parasysh një vlerësim i tillë. Ngjashëm me vendet tjera, duket se ka hapësirë për të përqendruar më shumë masa dhe kritere për ridrejtimin e aktivitetëve kah ndërhyrjet më miqësore ndaj klimës, si pjesë e rimëkëmbjes nga COVID-19.

Ndjej kënaqësi të them se në Maqedoninë e Veriut kanë vazhduar disa aktivitete të rëndësishme në lidhje me mjedisin jetësor, pavarësisht ndikimit nga kriza COVID-19. Parku i ri nacional - Mali Sharr - është në krijim e sipër në sajë të punës së përkushtuar të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Programit të OKB-së për Mjedisin Jetësor (UNEP), bashkëpunimit gjerman, fakulteteve shtetërore dhe shumë organizatave dhe aktivistëve të shoqërisë civile si p.sh. platforma "Miq të Sharrit", Shoqata Ekologjike e Maqedonisë,

Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe EuroNatur. Kjo do të rezultojë në një menaxhim të përmirësuar dhe më të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për më tepër, aktivitetet për ruajtjen e biodiversitetit në liqenin e Ohrit gjithashtu po përparojnë, përfshirë edhe përforcimin e mëtejshëm të menaxhimit të zonave të mbrojtura në të gjithë vendin. Në fund të vitit 2020, Maqedonia e Veriut gjithashtu u angazhua për një synim ambicioz nacional për zvogëlimin e emetimit të gazrave serë deri në vitin 2030 dhe për rritjen e kontributeve të përcaktuara në nivel nacional.



Shumë sfida qëndrojnë përpara arritjes së "rimëkëmbjes së vërtetë, të gjelbër", e cila duhet t'i shqyrtojë sfidat e ngutshme mjedisore në rrafshin nacional, siç është ulja e emetimeve që kontribuojnë në ndotjen e ajrit dhe problemet e menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe ujërave të zeza. Këto mundësi duhet të shfrytëzohen kur vihet në fokus rimëkëmbja afatmesme dhe afatgjate, ndërsa "e gjelbra" duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e punës sonë. Rritja ekonomike dhe qëndrueshmëria mjedisore duhet të shihen të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën. Zgjidhjet e paraqitura duhet të jenë reciprokisht plotësuese dhe përforcuese, si dhe duhet të jenë të zbatueshme në të gjitha nivelet - përmes veprimeve të komuniteteve dhe individëve. Përderisa mbeten të kufizuara burimet financiare në dispozicion, investimi me mençuri në masat që njëkohësisht e përshpejtojnë rimëkëmbjen ekonomike dhe atë të gjelbër duhet të ngelin ndër kriteret tona kryesore të vendimmarrjes.

Rosana Duxak
Koordinator i Përherhshëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

AKTIVITETET E PËRGGJIGJES DHE RIMËKËMBJES NGA KOVID-19

Agjencitë e OKB-së vazhdojnë ta mbështesin përgjigjen ndaj COVID-19 në vend me analizë të posaçme dhe të fokusuar në çështjet brenda sferave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Organizata Botërore e Punës (ILO) e ka mbështetur raundin e dytë të hulumtimit mbi sipërmarrjet “[Sfidat dhe pritjet në zhvillim, me të cilat përballen sipërmarrjet e Maqedonisë së Veriut gjatë pandemisë COVID-19](#)”. Shumica dërrmuese e ndërmarrjeve (83%) e kanë rifilluar punën e tyre në tremujorin e katërt të vitit 2020; shumica prej tyre (86%) kanë regjistruar rënie të të ardhurave për shkak të COVID-19 krahasuar me vitin 2019, ndërsa një pjesë e konsiderueshme (64%) i kanë përdorë rezervat e tyre për ta kompensuar fluksin e paqëndrueshëm ose të pamjaftueshëm të parave. Ngjashëm si në periudhën prill-maj 2020, vetëm një pjesë e vogël e ndërmarrjeve (12%) e kanë zbatuar masën e pushimit të punëtorëve nga puna përkundër sfidave masive ekonomike të shkakta nga pandemia. Për të ndërtuar qëndrueshmëri të biznesit, mbi gjysma e ndërmarrjeve (52%) kanë ofruar produkte dhe shërbime të reja ose e kanë modifikuar sistemin e eksistues të funksionimit përmes punës nga distanca (telepunimi), një opsion i përdorur rrallë para pandemisë (9%). Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (61%) kanë shprehur pakënaqësi relative ndaj adekuatshmërisë së masave kundër krizës, ndërsa 47% kanë menduar që Qeveria i ka adresuar kërkesat kryesore të biznesit në pakon e katërt të masave të mbështetjes ekonomike.

Më 23 mars, **Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)** organizoi një prezantim të rezultateve të projektit të përbashkët mes OBSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbështetja e shëndetit publik dhe kujdesit emergjent gjatë valës së dytë të COVID-19 në Maqedoninë e Veriut”, të financuar nga Mbretëria e Bashkuar. Projekti afatshkurtër zhvilloi ndërhyrje të shpejta dhe të bazuara në prova për ta mbështetur fuqinë punëtore të riorientuar së fundmi në sigurimin e kujdesit të sigurt dhe cilësor kundër COVID-19, duke zhvilluar dhe realizuar trajnime speciale të përshpejtuara për punonjësit shëndetësorë në aspekte të ndryshme të kontrollit dhe parandalimit të infeksionit në mjediset e kujdesit shëndetësor, kujdesit kundër COVID-19 dhe shëndetit mendor; si dhe hulumtimin e zgjidhjeve themelore të trajnimit afatmesëm për rritjen e kërkesave për rolin, kapacitetin dhe kompetencat e shërbimeve të infermierisë, kryesisht për kujdesin primar dhe për komunitetin.

Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR) ka dhuruar pajisje TL, pajisje për mbrojtje personale (PMP) dhe mbulesa për shtretër në Spitalin e Përgjithshëm në Gjevgjeli dhe qendrën lokale për punë sociale. Të dy institucionet kanë ofruar vazhdimisht shërbime për refugjatët, azilkerkuesit dhe migrantët në jug të vendit, përfshirë edhe gjatë pandemisë COVID-19.

AKTIVITETE TJERA

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) e ka nisur një veprim të përbashkët të bashkimit Evropian (BE)-UNODC mbi promovimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të synuara të kontrollit kufitar në porte dhe aeroporte. Veprimi në fjalë zbatohet përmes bashkëpunimit me [Programin për kontroll të kontejnerëve \(PKK\)](#) të UNODC-së dhe Organizatës Botërore të Doganave (OBD) dhe [Projektin për komunikim të aeroporteve \(AIRCOP\)](#) të UNODC-së, OBD-së dhe INTERPOL-it (AIRCOP) me Programin Rajonal të UNODC-së për Evropën Juglindore. Qeveria, e përfaqësuar nga Ministria e Brendshme dhe UNODC-ja zyrtarisht kanë rënë dakord për ta ndjekur bashkëpunimin në fushën e kontrollit të zgjeruar të kufirit në kuadër të nismës BE-UNODC, duke e nënshkruar një Marrëveshje të përbashkët.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) është i angazhuar në promovimin e Planit të ardhshëm operacional të masave dhe programeve aktive të punës, i përqendruar në pilotimin e qasjeve të ekonomisë së kujdesit, të përshtatura për

vendin, duke i trajtuar tre fronte në të njëjtën kohë: kujdesin më të mirë social për më të rrezikuarit; vendet e reja të punës për gratë; dhe lehtësimin nga puna e kujdesit të papaguar, që aq shpesh e vonon punësimin e grave.

UN Women e ka mbështetur Edicionin e [12-të të Netëve të të Drejtave të Grave \(NDG\)](#), një alternativë kulturore në përkujtimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, nën patronazhin e Qytetit të Shkupit, zbatuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe Award Film & Video nga Shkupi. Këtë vit, NDG12 ishte nikoqir i ekranizimit të filmave “Dita e Gruas” dhe “Forte” në platformën e internetit cinesquare.net, po ashtu ishte nikoqir i një debati në internet “Krizat nuk janë neutrale gjinore: Si ndikon lidhshipi i grave në barazinë gjinore në kohën e COVID-19?”, dhe ekspozitën ndërkombëtare “Zgimi 2”, me vepra arti nga gratë artiste. Në maj, filmat do të shfaqen në kinemanë verore në Kinoteka të Shkupit.

UN Women e organizoi takimin e dytë të Bordit Këshillimor të projektit “Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, të financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Zhvillim. Në takim u diskutuan arritjet kryesore në zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, përfshirë zhvillimet e rëndësishme në politikën nacionale dhe kornizën ligjore për avancimin e barazisë gjinore.

UN Women siguroi mbështetje për vlerësimin e progresit në zbatimin e Strategjisë Nacionale për Barazinë Gjinore (2013-2020). Gjatë dëgjimit publik të organizuar nga Komisioni parlamentar për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në fillim të marsit u shpalosën vlerësimet kryesore, rekomandimet dhe përparësitë e reja strategjike.

Indeksi i Qeverisjes së Migracionit (IQM) do të zbatohet për herë të parë në Maqedoninë e Veriut në kuadër të projektit “Planifikimi dhe ligjërimi i politikës së migracionit në Maqedoninë e Veriut të bazuar në prova” i zbatuar bashkërisht nga **Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)**, **Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA)** dhe UNHCR-ja. IQM-ja ofron pasqyrë mbi shtytësit e politikave që vendet mund t’i përdorin për ta zhvilluar qeverisjen e tyre të migracionit: indeksi në fjalë është krijuar për t’i ndihmuar vendet të vlerësojnë gjithë përfshirjen e politikave të tyre të migracionit dhe t’i identifikojnë boshllëqet dhe fushat që mund të fuqizohen.

OBSH-ja organizoi një diskutim në internet “Dialogu i të Moshuarve” më 22 mars të vitit 2021, gjatë të cilit u prezantuan rezultatet e të OBSH-së lidhur me vlerësimin e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor në lidhje me plakjen në Maqedoninë e Veriut, të realizuar midis shtatorit 2019 dhe janarit 2020. Ky vlerësim e theksoi informacionin e disponueshëm demografik nacional të grupit të popullsisë së moshuar, cenusshmërinë e tyre dhe kushtet specifike shëndetësore, si dhe nevojën për të arritur mbulim shëndetësor universal dhe transformim të shërbimeve shëndetësore, duke punuar drejt një kujdesi më të fokusuar, të integruar dhe të përqendruar të personi. Përderisa vendi po përfaqësohet të prezantojë modelin e ri të kujdesit shëndetësor primar, vëmendje e veçantë nevojitet që të sigurohet që njerëzit e moshuar të mos lihen pas.

Në suaza të projektit STAR5 të Mekanizmit Global të Mjedisit (GEF), **UNEP** organizoi së bashku me partnerët [një ngjarje fillestare në internet](#) e cila e shënoi fillimin e zbatimit të aktivitetit për të zgjedhur dy pilot korridore nga Rrjeti ekologjik nacional i propozuar (MAK-NEN) për zhvillimin dhe testimin e lokacionit-masat specifike që përfshijnë palët e interesuara lokale për menaxhimin dhe restaurimin e pyjeve me vlerë të lartë të natyrës dhe habitateve tjera.

Zyra e OKB për Shërbimet e Projektit (UNOPS) vazhdon punën e saj për aftësimin e shërbyesve civilë në procesin e integritetit në BE përmes projektit Mbështetja Nordike për Progres në Maqedoninë e Veriut. Një seri trajnimesh

u organizuan në mars dedikuar Sekretariatit për Çështje Evropiane, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Ekonomisë dhe institucioneve tjera qeveritare për aspekte të ndryshme të procesit të anëtarësimit në BE.

Me mbështetjen e UNHCR-së, Qendra për ligjin, refugjatët dhe migracionin (Fakulteti i Drejtësisë “Justinian Prima” në Shkup) dhe Qendra për edukim klinik ligjor - Ligji për refugjatët dhe Qendra e migrimit e realizuan hulumtimin [“Refugjatët dhe migrimi në kontekstin e rrugës Ballkanike”](#). Ekipi i projektit u përqendrua në diskursin publik, politik dhe mediatic në Maqedoninë e Veriut në kontekstin e refugjatëve, migracionit, ksenofobisë, islamofobisë dhe nacionalizmit gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020. Studimi përfshin periudhën nga tetori i vitit 2019 deri më 15 korrik të vitit 2020.

Më 17 mars, **Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)** së bashku me partnerët shënuan njëvjetorin e portalit Eduino për arsimin digjital, koordinimin dhe zhvillimin profesional. Portali Eduino është pjesë e Programit Kohezioni Social dhe Dialogu Kulturor, Bazë për të Ardhmen, i mbështetur financiarisht nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe i zbatuar nga UNICEF-i në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa i menaxhuar nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit me mbështetje nga SmartAp-i – Labortori për inovacion social.

Kryetari i Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski dhe UNICEF-i e promovuan më 8 shkurt një iniciativë të re të përbashkët “Rimagjini të Ardhmen”, e cila synon t’u jep fëmijëve dhe të rinjve hapësirë për t’u angazhuar në përcaktimin e vizionit, që ata e duan për të ardhmen e tyre dhe gjeneratat e ardhshme. Gjatë tre muajve të ardhshëm, të rinjtë do të kenë mundësi të bashkohen me konsultat për të diskutuar çështje që kanë rëndësi për ta, sfidat e tyre më të mëdha, shpresat për të ardhmen e vendit dhe hapësirën për të propozuar zgjidhje për ta kthyer vizionin në realitet.

ILO e ka mbështetur Organizatën e Punëdhënësve të Maqedonisë për të zhvilluar një shërbim të ri dhe për ta realizuar anketën e parë gjithëpërfshirëse të pagave në [konkursin e sektorit privat SALAR](#), duke synuar t’ua sigurojë kompanive informacionin e duhur për kostot e punës për 178 profile dhe pozicione pune, në mënyrë që ata të mund t’i zgjedhin dhe azhurnojnë politikatat e tyre të burimeve njerëzore, në mënyrë që të jenë më konkurrues.

Federata e Sindikatave të Maqedonisë (FSM) e ka filluar ratifikimin e Konventës 190 të ILO-s Dhuna dhe ngacmimi në punë, e cila është pranuar unanimisht nga të gjithë partnerët socialë në seancën e 10-të të Këshillit Ekonomik dhe Social, të mbajtur më 18 mars të vitit 2021. Konventa pranon që dhuna dhe ngacmimi në sferën e punës “mund të përbëjnë shkelje ose abuzim të të drejtave të njeriut, është kërcënim ndaj mundësisë të barabarta, është e papranueshme dhe jo e përputhshme me parimin e punës së denjë”. Ajo e përcakton “dhunën dhe ngacmimin” si sjellje, praktika ose kërcënimë “që synojnë, rezultojnë ose ka të ngjarë të rezultojnë në dëm fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik”. Kjo konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qofshin privatë ose publikë, si në ekonomitë formale ashtu edhe në ato joformale, qoftë në zonat urbane ose ato rurale.

KBZhQ 2021-2025 Programe dhe strategji individuale të agjencive të OKB-së

Korniza për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm e OKB-së (Maqedonia e Veriut) 2021-2025 (KBZhQ) zbatohet përmes instrumenteve të programit të agjencive të OKB-së në vend që e kanë nënshkruar KBZhQ-në në frymën e sistemit për zhvillim, dhe burojnë nga vetë KBZhQ-ja. Programi individual dhe dokumentet strategjike të UNHCR-së dhe UNODC-së janë paraqitur më poshtë në detaje.



UNHCR

Në përputhje me ndryshimet e saja globale organizative, UNHCR-ja në Maqedoninë e Veriut ka zhvilluar strategji shumëvjeçare të vendit, duke i përdorur metodat globale të së ardhmen dhe të parashikimit, si dhe të qasjeve tjera të reja për të siguruar zgjidhje inovative për sfidat në suaza mandatit të saj. UNHCR-ja angazhon një spektër të larmishëm të protagonistëve për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku të gjithë refugjatët janë të mbrojtur dhe askush nuk është pa shtetësi.

Për ta realizuar vizionin tonë, UNHCR-ja fokusohet në këto prioritetet dhe transformimet strategjike:

- 1) Mbështetja e aftësive të qeverisjes parashikuese. Puna me pushtetet nacionale dhe lokale, agjencitë e OKB dhe shoqërinë civile (përfshirë akademinë, mediat dhe qytetarët) për të ndërtuar aftësi parashikuese për të kaluar në politika publike afatgjata, të zhërvjellëta, për ta përmirësuar qëndrueshmërinë dhe përcaktimin e përparësive si një mënyrë për ta çuar përpara agjendën e mbrojtjes në vend. Plani pjesëmarrës do të përdoret për ta mbështetur Maqedoninë e Veriut në krijimin e kushteve për t'i adresuar çështjet e afërta dhe shkaqet e tyre themelore.
- 2) Transformimi i narracionit publik për refugjatet duke nxitur ndryshimin dhe ndërtimin e qëndrimeve dhe sjelljeve pozitive në komunitete dhe shoqëri. Zgjerimi i platformës së palëve të interesuara për ta luftuar keqinformimin dhe rrëfimin përçarës. Për të përmirësuar rrëfimin ekzistues rreth refugjatëve dhe imigracionit dhe për të nxitur ndryshime të qëndrueshme shoqërore, do të projektohet në një qasje të re ndaj komunikimeve. Një kuptim më i mirë i çështjeve të refugjatëve do të çojë në një rritje në hapësirën e mbrojtjes, do ta stimulojë një mjedis më të favorshëm për integrim dhe do ta përmirësojë mbrojtjen e personave në nevojë.
- 3) Përforcimi i avokimit duke u angazhuar strategjikisht me një spektër të gjerë të palëve të interesuara të zgjedhura për ta mobilizuar mbështetjen, duke përfshirë njerëzit përkatës dhe shoqërinë civile si protagonistët e ndryshimit.
- 4) Mbështetja e sistemit të hyrjes të ndjeshëm ndaj mbrojtjes. Sensibilizimi dhe aftësimi i homologëve nacional për t'u përmbajtur plotësisht përgjegjësive të tyre, për të siguruar qasje efektive në territorin e personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. UNHCR-ja e mbështet krijimin e regjistrimit sistemor, profilizimin e ndjeshëm ndaj mbrojtjes dhe referimin adekuat të të gjithë individëve që arrijnë në lëvizje të përziera, për të siguruar që askush të mos lihet pas.
- 5) Përmirësimi cilësorë së azilit. Mbështetja e krijimit të një sistemi të azilit plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar qasje sistematike të papenguar në azil, procesim të drejtë dhe efikas të kërkesave të azilit, duke përfshirë shqyrtimin thelbësor gjyqësor, ndihmën juridike falas të qëndrueshme dhe cilësore, si dhe standarde adekuate të pritjes.
- 6) Përkrahja e gatishmërisë për përgjigje të mbrojtjes humanitare. Mbështetja e autoriteteve nacionale dhe të gjithë partnerëve humanitarë dhe të mbrojtjes për të siguruar

gatishmërinë për reagim adekuat humanitar dhe mbrojtës, në rast të fluksit të refugjatëve/migrantëve, përfshirë: analizën dhe monitorimin e rregullt të rreziqeve, si dhe zhvillimin e një plani të paparashikuar, të përshtatur me nivelin e rrezikut të fluksit.

7) Zgjidhja nxitëse. Duke ndjekur qëllimin për ta përmirësuar sistemin e azilit, për të ndikuar në ndryshimet legjislative dhe politike, për krijim të kushteve optimale për integrim lokal të refugjatëve dhe përfshirje të azilkerkuesve, përmes së cilës ata kanë qasje të plotë në të drejtat sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit nacional. Zhvendosja e zgjatur e refugjatëve nga Kosova duhet të përfundojë në një mënyrë dinjitoze dhe të qëndrueshme. Si një kontribut në objektivat e Kompaktit Global për Refugjatët do të pilotohen mekanizma plotësues edhe atë fillimisht në fushën e arsimit.

8) Përfundimi i pashtetësisë në Maqedoninë e Veriut deri në vitin 2024, brenda kornizës së vendosur nga [#Fushata unë i përkas](#) dhe mbështetja e Maqedonisë së Veriut në këtë ambicie.



Strategjinë e re të UNODC 2021-2025

Më 18 shkurt 2021, Drejtori ekzekutiv i UNODC-së e filloi zyrtarisht [Strategjinë e re të UNODC 2021-2025](#) që përcakton vizionin e UNODC dhe do ta drejtojë punën e vet në Evropën Juglindore dhe në nivel global.

Strategjia e avancion misionin qëndror të UNODC-së – për të kontribuar në paqen dhe sigurinë globale, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin duke e bërë botën më të sigurt nga drogat, krimi, korrupsioni dhe terrorizmi - dhe e përshtat mbështetjen e UNODC-së gjatë pandemisë dhe më gjerë, ndërsa e nënvizon angazhimin e organizatës për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, si dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe shfrytëzimin e fuqisë transformuese të të rinjve.

Strategjia përqendrohet në pesë fusha kryesore tematike, të cilat e integrojnë politikën dhe punën programore: (1) adresimi dhe lufta kundër problemit botëror të drogës, (2) parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar, (3) parandalimi dhe kundërvëprimi ndaj korrupsionit dhe krimit ekonomik, (4) parandalimi dhe lufta kundër terrorizmit, dhe (5) parandalimi i krimit dhe drejtësia penale.

Për t'u përballë me këto sfida që janë përkeqësuar nga pandemia COVID-19, UNODC-ja mbështetet në një prani të gjerë në terren që ofron njohuri rajonale dhe nacionale, si dhe kërkime dhe analiza me cilësi të lartë.

UNODC do t'i përdorë pikat e saja të forta në përaftrimin e vendeve për të përcjellë njohuri, aftësi dhe informacione, me qëllim të adresimit të sfidave të përbashkëta dhe për gjetje të zgjidhjeve efektive në nivelet operative, ligjore dhe politike. Koordinimi dhe integrimi i forcuar anekënd UNODC-së do të sigurojë që puna normative, kërkimore dhe e asistencës teknike të jenë reciprokisht përforcuese dhe të afta për t'u tërhequr nga njëra tjetra - duke punuar për t'i identifikuar me shpejtësi tendencat dhe kërcënimet e reja, për t'i zhvilluar përgjigjet që janë të nevojshme për t'u kundërvënë atyre dhe për t'i ndarë dhe vënë në praktikë ato njohuri me qëllim të mbështetjes së shteteve anëtare.

Çelësi për zbatimin e suksesshëm do të jetë përdorimi i zgjeruar i partneriteteve me një spektër më të gjerë të palëve të interesuara. Komunikimi efektiv do të jetë gjithashtu kritik, nga brenda duke e përmirësuar përkrahjen e ndërsjellë në të gjithë zonat tematike dhe nga jashtë duke e shfaqur ndikimin e punës sonë. UNODC-ja do t'i rishikojë dhe rregullojë strukturat, sistemet dhe proceset e brendshme në mënyrë që të mund ta shfrytëzojmë potencialin e plotë të stafit tonë për t'i

përbushur nevojat e shteteve anëtare në zhvillim të shpejtë: në mënyrë që t'i vënë në përdorim inovacionet, t'i përdorin teknologjitë e reja dhe të krijojnë një kulturë organizative të bazuar në besim, respekt dhe përgjegjësi.

[Programi Rajonal për Evropën Juglindore \(PR EIL\)](#), i cili e siguron kornizën për aktivitetet e UNODC në rajon, përfshirë Maqedoninë e Veriut, i mbështet juridiksionet e rajonit në përpjekjet e tyre kundër sfidave të paraqitura nga krimi i organizuar dhe korrupsioni. Në vitin 2020, UNODC-ja e ka forcuar edhe më tej praninë e vet dhe bashkëpunimin me Maqedoninë e Veriut në kuadër të tre projekteve të mëdha në vend dhe rajon për t'i adresuar këto çështje:

1) Aksion i përbashkët BE-UNODC për promovimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të synuara të kontrollit të kufirit në porte dhe aeroporte;

2) Zhvillimi i një Udhërrëfyesi rajonal për luftë kundër korrupsionit dhe financimit të paligjshëm për ta përmirësuar zbatimin e masave ekzistuese kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme; dhe

3) Projekti rajonal për përgjigje ndaj drejtësisë penale kundër trafikimit të armëve, që synon mbështetjen e gjashtë juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Maqedoninë e Veriut në forcimin e përgjigjes së tyre të drejtësisë penale ndaj kriminalitetit në lidhje me armët e zjarrit, veçanërisht trafikimin e paligjshëm të armëve.

Përmes këtyre aktiviteteve kryesore, PR EIL i UNODC-së synon t'i mbështesë më tej autoritetet nacionale për përballje me sfidat globale në përputhje me përparësitë e përshkruara në strategjinë e UNODC së bashku me mjetet për t'i arritur rezultatet, duke përfshirë komunikimin e zgjeruar, bashkëpunimin dhe përkrahjen.

Në fokus Të dhënat

Të dhënat janë pasuria më e madh e shekullit 21. A i përdorim ato deri në potencialin e plotë tyre?

Kush dëshiron të flet për të dhënat?

Ne nuk shohim shumë duar të ngritur. Nuk është befasi. Në të kaluarën të dhënat kanë qenë ndër temat më pak të popullarizuara. Gjenerimi i vlerës nga të dhënat shpesh ishte një shqetësim i izoluar i profesionistëve të teknologjisë së informacionit, operacioneve, ose ekspertëve gjeohapësinorë dhe atyre të të statistikave. Ato ishin të paketuara në raporte të shumta, të vendosura në raftë ose të ruajtura në kompjuterët e dikujt.

A është ndryshuar kjo?

Po gjithsesi, madje pandemia COVID-19 e ka theksuar më tej rëndësinë e të dhënave dhe numrave: numrin e shtretërve spitalorë, kapacitetet e testimit, maskat e nevojshme, të infektuarve dhe viktimave etj. Rëndësia e të dhënave dhe statistikave në kohë reale, cilësore, të hapura dhe të ndara është ritheksuar nga kriza COVID-19. Cilët janë njerëzit në rrezik më të lartë për të rënë në varfëri? Sa vende pune janë humbur? Kush dhe sa kanë nevojë për mbështetje urgjente, ku janë ata? Këto të dhëna janë kritike për t'i kuptuar, menaxhuar dhe zbutur efektet e pandemisë ndaj njerëzve, shoqërisë dhe ekonomisë. A kanë qenë lehtësisht e disponueshme? Jo. Këto të dhëna janë gjithashtu thelbësore për hartimin e përgjigjeve afatmesme dhe afatgjata dhe veprimet e përsheptuara për ta kthyer vendin në rrugën e duhur drejt zhvillimit të qëndrueshëm, dhe me këtë, për t'i mbështetur arritjet e QZHQ-ve dhe progresin e bërë drejt reformave të pranimit në BE.

Rëndësia e gjenerimit konstant të të dhënave të sakta, cilësore dhe në kohë reale

Të dhënat me cilësi të mirë i informojnë liderët, i angazhojnë nëpunësit civilë dhe i përfshijnë qytetarët në krijimin e politikave të bazuara në prova, të bazuara në të dhëna në kohë reale, të cilat mundësojnë planifikim strategjik të shkathët. "Veprimi të përgjegjshëm të të dhënave" ndihmojnë në trajtimin më të shpejt dhe më të mirë të përparësive.

Regjistrimi i popullsisë dhe familjeve është burimi më i rëndësishëm i të dhënave që mundëson kuptimin e mirë të nevojave të popullsisë në një vend - nga trendët e përgjithshëm e deri te variancat e imëta dhe të ndërlydhura midis atyre që jetojnë në komunitete urbane dhe rurale, të rinjtë dhe të moshuarit, burrat dhe gratë, arsimi, të ardhurat, aftësitë dhe interesat e ndryshme. Të dhënat lidhur me popullsinë në Maqedoninë e Veriut janë të vjetruara dhe jo të plota deri në atë masë, sa që mund t'i orientojnë gabimisht politikat që u dedikohen atyre që kanë më shumë nevojë për to, andaj krijonë diskriminim në vend se ta eliminojnë atë. Të dhënat e pasakta gjithashtu shprijnë në planifikim dhe shpenzim joefikas të fondeve të pakta publike. Për shembull: nuk ka një numër të saktë të personave me aftësi të kufizuara në vend. Kjo parandalon që shteti në nivelin lokal dhe nacional të hartojë politika dhe shërbime të përshtatshme, me çka bëhet sfidues planifikimi i duhur për ofrim të shërbimeve. Në këtë drejtim mungesa e një numri të mjaftueshëm të asistentëve personal të trajnuar dhe të certifikuar paraqet shembull konkret.

Prandaj, ekziston një konsensus se realizimi i regjistrimit, një operacion rreptësisht statistikor profesional i bazuar në Parimet themelore të statistikave zyrtare dhe në standardet dhe praktikën ndërkombëtare statistikore, është një përparësi për Maqedoninë e Veriut. Regjistrimi i popullsisë i realizuar përmes metodologjisë së kombinuar të vizitave në terren dhe përdorimit të regjistrave administrativë, të mbledhur në një bazë të të dhënave kompjuterike është një hap i madh përpara në përdorimin e teknologjisë për mbledhjen më të shpejtë dhe më të lirë të të dhënave, pastrimin dhe analizën, që do të mundësojë lëshimin më të shpejtë të rezultateve të shumëpëritura.



Priority 1

DECADE OF ACTION

At the heart of the 2030 Agenda are the 17 Sustainable Development Goals. For the Decade of Action, we will leverage the UN family's data potential everywhere we can and aim to mobilize governments, civil society and businesses.



Priority 2

CLIMATE ACTION

Climate change is already affecting every country on every continent, impacting lives and disrupting economies, both now and in the future. We will put emphasis on employing data and analytics for urgent climate action.



Priority 3

GENDER EQUALITY

25 years after the historic Fourth World Conference on Women in Beijing, where the Beijing Platform for Action was agreed upon, full gender equality around the world is still not a reality. Together with global partners, we will build better gender data and analytics capabilities.



Priority 4

HUMAN RIGHTS AND RULE OF LAW

Powered by the SG's Call to Action on Human Rights, we will form global coalitions for human rights-based approaches to data, fight hate speech online while upholding freedoms and strengthen human rights monitoring, analytics capabilities.



Priority 5

PEACE AND SECURITY

We will leverage data and analytics for the prevention, mediation and resolution of conflicts: for stronger analysis and recommendations, to deploy peacekeepers faster to where they are needed most, and to protect civilians and UN personnel.



Priority 6

GOVERNANCE AND ETHICS FOR THE FUTURE

In support of stronger global digital cooperation, we will help foster dialogue, the collaborative design and the implementation of data policies that advance the responsible human-rights-based use of data and drive innovation for people and planet.



Priority 7

UN REFORM

To accelerate UN reform, we will foster centres of excellence that catalyze stronger data and analytics capabilities, help account for reform benefits, foster transparency, raise performance, and build resilient supply chains.



Priority 8

DATA PROTECTION AND PRIVACY

Building on our Data Protection and Privacy Principles, our ambition is to strengthen dialogue with public and private stakeholders, and champion data protection and privacy capacity in the UN family.

Strategjia e të dhënave të Sekretarit të Përgjithshëm për veprim nga secili dhe në çdo vend me mprehtësi, ndikim dhe integritet

Teknologjia është me rëndësi thelbësore për menaxhimin e të dhënave në shekullin 21 për sa i përket mbështetjes së mbledhjes dhe ruajtjes së tyre – madje në mënyrë të paimagjineshme disa dekada më parë - për gjenerimin e tyre në kohë reale si "të dhëna të mëdha", që ne i nxjerrim nga përdorimi i telefonave celular, mediave sociale, imazheve satelitore/të dronëve, madje edhe emocioneve të njerëzve të regjistruara nga sensorë të instaluar rreth nesh. Analiza është bërë e mundur, e përbalueshme, më e lehtë dhe më e shpejtë, ndërsa shtytja për vizualizim i ka bërë të dhënat të kuptueshme dhe më të afërta për ekspertët dhe publikun më të gjerë.

Ndërtimi i kapaciteteve analitike dhe monitoruese është njësoj mjaft me rëndësi

Teknologjia ende nuk është përdorë në potencialin e saj të plotë, siç është nevoja për ndërtimin e aftësive nacionale kolektive në menaxhimin e të dhënave dhe krijimin e një kulture të përdorimit të metodologjive të parashikimit, lidhur me planifikimin strategjik të bazuar në prova. Mungesa e qeverisjes horizontale krijon të dhëna të fragmentuara, të cilat e pengojnë bashkëpunimin, cilësinë dhe përdorimin e të dhënave. Menaxhimi, përdorimi dhe ndarja e të dhënave do të jetë integrale për suksesin në vitet në vazhdim, ndonëse të dhënat nuk trajtohen si një aset strategjik i përbashkët që krijon një vlerë optimale. Sidoqoftë, arritja në një fazë ku aftësitë e të dhënave janë vërtet transformuese nuk do të ndodhë brenda ditës. Hapi i parë në këtë rrugëtim është përkushtimi për një shtet plotësisht të drejtuar nga të dhënat, ku të dhënat janë thelbësore për të gjitha strategjitë, ku të dhënat nxisin inovacion, janë të integruar në të gjithë ekosistemet dhe japin vlera optimale për njerëzit.

OKB-ja është plotësisht e përkushtuar në ndërtimin e kapaciteteve të të dhënave

Siç është zotuar në Kornizën për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do t'i mbështesë autoritetet nacionale në gjenerimin e të dhënave themelore, të besueshme dhe rregullisht të ndara, me qëllim të promovimit të vendimmarrjes së bazuar në prova, vizionit strategjik afatgjatë si dhe monitorimit dhe raportimit të QZHQ-ve. OKB-ja do ta mbështesë Regjistrimin si një moment kyç për sigurimin e të dhënave të besueshme, si dhe proceset për zhvillimin e dokumenteve të reja nacionale të planifikimit strategjik. Përfundimisht, do të promovojë qeverisjen e bazuar në parashikimin e veprimeve, që synon ta rrisë kapacitetin e planifikimit strategjik të institucioneve.

Strategjia e të dhënave të Sekretarit të Përgjithshëm për veprim nga secili dhe në çdo vend me mprehtësi, ndikim dhe integritet

Të dhënat i përshkajnë të gjitha aspektet e punës së OKB-ë. Gjurma, ekspertiza dhe lidhshmëria e OKB-së krijon mundësi unike për ta avancuar "veprimin e të dhënave" globale me mprehtësi, ndikim dhe integritet. Për të ndihmuar në zbërthimin e potencialit plotë të OKB-së, 50 agjencitë përkatëse e kanë hartuar bashkërisht Strategjinë e parë kolektive të të dhënave të OKB-së si një libër gjithëpërfshirës për ndryshim i drejtuar nga vetë të dhënat, që synojnë ndërtimin e të dhënave, kapaciteteve digjitale, teknologjike dhe inovative, që i nevojiten OKB-së për të arritur sukses në shekullin 21.

Strategjia e OKB-së për të dhënat e shteteve për ta drejtuar mbështetjen e OKB-së është në zhvillim e sipër

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do ta zhvillojë strategjinë e saj të lokalizuar të të dhënave për vendet që do t'i vënë në veprim përpjekjet globale të OKB-së dhe do ta përmirësojë kapacitetin e saj të lokalizuar të të dhënave. Strategjia në fjalë do të jetë një plan i hollësishtëm veprimi për të arritur sukses në raport me përkushtimin ndaj KBZHQ-së, në mënyrë që të mbështeten përpjekjet nacionale për shfrytëzim më të mirë të potencialit të të dhënave me qëllim që shteti të arrijë më afër përmbushjes së Agjendës 2030 dhe të përshpejtohet zbatimi i QZHQ-ve.

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 12 April 2021

www.un.mk